L I G J
Nr.7972, datë 26.7.1995

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7777, DATË 22.12.1993 "PËR SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7788, DATË 9.2.1994 DHE LIGJIN NR.7899, DATË 2.2.1995

Në mbështetje të nenit 23 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7777, datë 22.12.1993 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.7788, datë 9.2.1994 dhe ligjin nr.7899, datë 2.2.1995 në lidhjen nr.1, pika 2 "Taksa feneri", ndryshohet si më poshtë:

TAKSA PORTUALE	Për çdo ton neto regjistër të anijeve	Në dollarë USA Gjithsej për çdo anije
- Për anijet deri në 200 TNR	0,10	
- Për anijet nga 201 deri 500 TNR		20
- Për anijet mbi 501 TNR		50

Neni 2

Në lidhjen nr.1, pika 3 "Taksa për formalitetet e kryera nga organet e shëndetësisë, kapitenerisë së porteve dhe autoriteteve të tjera", ndryshon si vijon:

- Për anijet deri në 200 TNR	0,25	
- Për anijet nga 201 deri 500 TNR		100
- Për anijet nga 501 deri 2000 TNR		180
- Për anijet nga 2001 deri 4000 TNR		210
- Për anijet mbi 4001 TNR		300

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1191, datë 11.8.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha